



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyet

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nga: Alban Susuri – UD i udhëheqës të sektorit për prokurim Komuna e Prizrenit

Datë: 31. 12. 2025

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN 01. 01. 2025 DERI 31. 12. 2025

Zyra e Prokurimit ka staf në këtë përbërje: katër (4) zyrtar të qertefikuar për prokurim publik. Në vitin fiskal 2025 zyra e prokurimit ka zhvilluar këto aktivitete në kuadër të punëve dhe detyrave të punës.

1. Janë iniciuar gjithsej 146 procedura të prokurimit në të cilat përfshihen: Punë, shërbime dhe furnizime të vlerave të vogla, të mesme dhe të mëdha si dhe janë zhvilluar 26 procedura të vlerave minimale (8 furnizime dhe 18 shërbime)
2. Janë nënshkruar gjithsejtë 157 kontrata, prej tyre:
 - a. 21 kontrata janë të vitit fiskal 2024 (dhe një kontratë e vitit fiskal 2022)
 - b. Janë nënshkruar gjithsej 10 aneks kontrata në procedurat e prokurimit.
 - c. 157 kontratat e nënshkruara janë të vlerave minimale, vlerave të vogla, vlerave të mesme dhe vlerave të mëdha e në të cilat përfshihen: punë shërbime furnizime dhe konkurse projektimi si dhe janë vlera të procedurave njëburimore pa publikim të njoftimit për kontratë (Aneks kontrata)Vlera totale e kontratave të nënshkruara për vitin fiskal 2025 dei me 02. 12. 2025 është 41,642,150.46 euro
(në tabelarin në exel i keni të gjitha projektet dhe vlerat e kontratave për secilin projekt)
Në procedurat e prokurimit për vitin fiskal 2025 janë dërguar gjithsej 138 kërkesa për rishqyrtim.
3. Njëherit janë ngritë në sistem 138 VENDIME të autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesat për rishqyrtim të OE.
4. Në procedurat e prokurimit për vitin fiskal 2025 janë parashtruar gjithsejtë 80 ankesa, për 77 është bërë zgjidhje lidhur me ankesën, ndërsa 3 ankesa janë në proces të pritjes së vendimeve të OSHP së për procedim të mëtejme.
Zyra e prokurimit gjegjësisht zyrtarët e kësaj zyreje kanë kryer edhe punë dhe detyra të punës të cilat i ngarkohen me ligj dhe me përshkrim të detyrave të punës

Alban Susuri

UD i udhëheqës të sektorit për prokurim Komuna e Prizrenit

03820044794

